



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.332/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit “Kompania Eskavatori” Shpk, me NUI:81064616, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, kundër të paditurës Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin Vendimi Nr.268/2020 të datës 21.09.2019, jashtë seancës me datën 22.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT, për të vendosur sipas padisë të paditësit “Kompania Eskavatori” Shpk, me NUI:81064616, me seli në Prishtinë.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dosja e lëndës më të gjitha shkresat e saj i dërgohet DEPARTAMENTIT FISKAL të Gjykatës Komerciale.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2020 Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative Divizionit Civil paditësi ka parashtruar padi paditësit “Kompania Eskavatori” Shpk, me NUI:81064616, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, kundër të paditurës Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin Vendimi Nr.268/2020 të datës 21.09.2019. Lëndë është evidentuar me A.1622/2020.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentin Administrativ Gjykatë Komerciale Departamentin Administrativ dhe evidentohet me shifrën KA 332/22.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata vlerësoj se vendimi i kundërshtuar ka të bëjë me Masën 3a nga Pakoja Fiskale Emergjente i nxjerrë nga Ministria e Financave për të cilën është kompetent Departamenti Fiskal i kësaj gjykate, sipas Ligjit (NR. 08/L-015) për Gjykatën Komerciale, Neni 13 ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale me juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe kompetenca e secilit departament në Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas paragrafit 4. *Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal;* e që në nën-paragrafin 1.11. *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore.*

Ndërsa, në Departamentin për çështje administrative, në shkallë të parë sipas paragrafit 5, të njëjtit Nen hyjnë *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të njëjtit Nen.*

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.332/24, datë 23.04.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.